

VENDIM
Nr. 28, datë 17.1.2024

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 606, DATË 20.10.2021, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË
PËRGJEGJËSISË SHETETËRORE TË MINISTRISË SË DREJTËSISË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 4, të vendimit nr. 606, datë 20.10.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Drejtësisë”, fjalët “... në rolin e Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit, bashkërendon punën për hartimin e politikave dhe përgatitjen e akteve ligjore e nënligjore për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit, si dhe ...” hiqen.

2. Ngarkohet Ministria e Drejtësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku